



# MANUAL

PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE  
ME AFTËSI TË KUFIZUAR  
NË BASHKINË KAVAJË



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Programi Rajonal mbi Demokracinë  
Vendore në Ballkanin Perëndimor





# MANUAL

## PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË BASHKINË KAVAJË



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Programi Rajonal mbi Demokracinë  
Vendore në Ballkanin Perëndimor




Korrik, 2024

Autorë:

Edlira Ngjeci Shima, PhD.

Olta Qejvani, PhD candidate.



**Ky projekt mbështetet nga:**

**#ReLOaD**

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit «Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2», i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACFD) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>Lista e shkurtesave 6</b>	
<b>I. Legjislacioni për fëmijët me aftësi të kufizuara</b>	<b>7</b>
1.1 Ligjet kryesore në Shqipëri për fëmijët me aftësi të kufizuara	7
1.2 Disa dokumenta strategjikë (të tjerë) të rëndësishëm	8
<b>II. Instrumentet dhe procesi i diagnostifikimit 10</b>	
2.1. Koncepte të përgjithshme të instrumentave dhe procesit të diagnostifikimit	10
2.2 Instrumentat dhe hapat sipas OBSH (Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë)	10
2.3 Identifikimi dhe pranimi	11
<b>III. Çrregullimet dhe procesi i menaxhimit të aftësisë ndryshe të fëmijës</b>	<b>13</b>
3.1. Llojet e çrregullimeve	13
3.2 Llojet e shërbimeve	16
<b>IV. Strukturat mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara</b>	<b>18</b>

## 1. Hyrje

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACFD) në kuadër të zbatimit të projektit “Vlerëso-Fuqizo-Vepro: stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kavajës”, nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, i cili financohet nga Bashkimit Europian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Bashkinë Kavajë, ka ndërmarrë përsipër hartimin e manualit për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky manual i shërben prindërve për të evidentuar një set hapash për të identifikuar problematikat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për të orientuar hapat dhe proceset përkatëse për bashkëpunimin me strukturat përkatëse si dhe aspekte të prindërimit përgjatë rritjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Manuali për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara është një burim i rëndësishëm për të ndihmuar ata në kuptimin dhe mbështetjen e nevojave të tyre të veçanta. Ky manual është hartuar bazuar në rekomandimet e mëposhtme:

*Edukim dhe informacion:* Sigurohuni që prindërit të kenë informacion të mjaftueshëm për aftësitë e kufizuara të fëmijës së tyre. Kjo përfshin të kuptuarit e diagnozave të mundshme dhe të kufizimeve të identifikuara të fëmijës.

*Ndërtimi i një bashkëpunimi:* Inkurajoni prindërit të ndërtojnë një marrëdhënie bashkëpunimi me pediatrin, psikologun dhe të gjithë profesionistët e tjerë që janë të përfshirë në trajtimin e fëmijës me aftësi të kufizuara. Kjo siguron një përkrahje të qëndrueshme dhe të koordinuar për fëmijën.

*Krijimi i një ambienti të përshtatshëm:* Ndhmoni prindërit të organizojnë dhe përshtatin mjedisin e shtëpisë për të përmbushur nevojat e fëmijës. Kjo përfshin strukturimin e rutinës së tyre, organizimin e materialeve didaktike, dhe përshtatjen e shtëpisë për të lehtësuar përfshirjen dhe pavarësinë e fëmijës.

*Përqendrimi në forcimin e aftësive:* Inkurajoni prindërit të fokusohen në forcimin e aftësive të fëmijës, në vend të fokusit vetëm në kufizimet dhe vështirësitë. Mësoni prindërit të dinë të përkrahin dhe vlerësojnë progresin dhe arritjet e fëmijës me aftësi të kufizuara, duke i inkurajuar ata të zhvillojnë aftësi të reja dhe të përmbushin qëllimet e tyre personale.

*Kujdesi për veten:* Inkurajoni prindërit të kujdesen për veten e tyre. Kujdesi i prindërve për shëndetin e tyre emocional dhe fizik do t'i ndihmojë ata të jenë më të aftë për të ofruar mbështetje të qëndrueshme dhe cilësore për fëmijën e tyre.

*Komuniteti dhe mbështetja e jashtme:* Ndhmoni prindërit të lidhen me burime dhe grupe mbështetëse në komunitet, duke përfshirë organizata lokale, grupet e prindërve e të tjerë me përvojë të ngjashme, dhe shërbimet e mbështetjes sociale dhe arsimore.

*Përgatitja për të ardhmen:* Inkurajoni prindërit të mendojnë për nevojat afatgjata dhe afatshkurtra të fëmijës, duke përfshirë planifikimin e arsimit të

tyre, përfshirjen sociale dhe shfrytëzimin e mundësive për zhvillim të aftësive për një pavarësi më të madhe.

Ky manual mund të përdoret nga prindërit ose kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Manuali ka synuar që:

Të ofrojë këshilla praktike mbi procesin e identifikimit, pranimit dhe fillimit të kërkimit për ndihmë.

Të paraqesë procesin dhe vijueshmërinë për ndjekjen e ecursisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe llojet e problematikave, çrregullimeve.

Të parashtrijë një hartë të aktorëve të ndryshëm të cilët mund të kërkohet ndihmë.

Manuali është bazuar në literaturën bashkëkohore shqiptare dhe atë ndërkombëtare/evropiane duke krijuar lidhjet përkatëse dhe të duhura me realitetin shqiptar. Një aspekt i rëndësishëm i metodologjisë mbi të cilin është ngritur ky udhëzues ka qenë diskutimet e drejtëpërdrejta me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë Kavajë lidhur me vështirësitë me të cilat hasen në të përditshmen e tyre si dhe nevojat e tyre për informacion.

## LISTA E SHKURTESAVE

---

<b>ACFD</b>	Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
<b>AK</b>	Aftësi e Kufizuar
<b>BE</b>	Bashkim European
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>PAK</b>	Persona me Aftësi të Kufizuara
<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## I. LEGJISLACIONI PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në këtë rubrikë do të gjeni një panoramë të plotë të kuadrit ligjor dhe strategjik që mund të konsultoni për fëmijët me aftësi të kufizuara, burimet kryesore, parimet që ligjet dhe politikat përkatëse promovojnë si dhe një përshkrim të dokumentave strategjikë aktualë të cilat luajnë një rol kryesor në trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edhe pse ligjet dhe zbatimi i tyre s'është mjaftueshëm për menaxhimin e suksesshëm të rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, një botëkuptim sa më i qartë, konkret dhe i duhuri i kësaj panorame është thelbësore në kujdesin dhe përkushtimin që prindërit duhet t'i ofrojnë dhe kërkojnë ndihmë për fëmijët me AK. Edhe pse është një rubrikë që i adresohet më shumë specialistëve të fushës, njohuria ndaj rregullave dhe ligjeve në fuqi është gjithnjë pushtet informativ në duart tuaja për të kërkuar mbështetjen e duhur për fëmijën tuaj.

### 1.1 Ligjet kryesore në Shqipëri për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në rast se do duhet që të eksplorojmë apo gjejmë një dokument ligjor, për fëmijët me aftësi të kufizuara do duhet që të gjejmë informacionin e nevojshëm në:

#### a. legjislacioni dhe politikat për shërbimet sociale/qendrat ditore e të tjera të ngjashme me to.<sup>1</sup>

Kjo paketë legjislative është e përditësuar në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror. Kjo faqe mund të aksesohet falas nga secili vizitor i interesuar. Aktet ligjore të cilat gjejnë zbatim të gjerë dhe që kanë fokus të veçantë janë:

- Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji 57/2019 Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë.
- VKM nr. 658, datë 17.10.2005 'Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore'.
- Vendim Nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

#### b. legjislacionin për personat me aftësi të kufizuara (PAK).<sup>2</sup>

Kjo paketë e plotë legjislative gjendet në përmbledhjen zyrtare nga Qendra e Botimeve Zyrtare, ndër të cilat jepen edhe instrumentet ndërkombëtarë për personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me fëmijët me

1 Shih bazën ligjore të përmbledhur në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror <https://www.sherbimisocial.gov.al/institucione-perkujdesi/legjislacioni/>

2 Shih botimin përmbledhës të Qendrës së Botimeve Zyrtare për personat me aftësi të kufizuara <https://uogj.edu.al/upload/Evidenacat%20shqip%202021/dok%20juridike/Permbledhese%20legjislacioni%20per%20personat%20me%20aftesi%20te%20kufizuar%202020.pdf>



aftësi të kufizuar, specifkisht i referohemi:

- Ligj-nr-93-dt-24.7.2014 'Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar'

- ***Udhëzim i përbashkët i MMSR dhe MSH nr. 21, datë 7.10.2016 'Për miratimin e kriterëve për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar te të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot'***
- Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre".
- Vendim Nr. 822, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore".
- Udhëzim Nr. 597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara".
- Linku Paketa\_ligjore\_\_per\_sherbimet\_e\_kujdesit\_shoqeror.pdf (adrf.al).

**c. legjislacionin e fëmijëve, duke evidentuar parimet dhe parashikimet e tjera ligjore për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës, duke përfshirë edhe rastet kur këta fëmijë janë me aftësi të kufizuara.**<sup>3</sup>

- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Kodi i Familjes.
- Ligji i ri 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
- VKM nr. 353, dt.12.06.2018 "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative".
- VKM nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".

## 1.2 Disa dokumenta strategjikë (të tjerë) të rëndësishëm.

Përtej ligjeve kryesore, edhe këto dokumenta janë fokus i rëndësishëm:

1. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030.

<sup>3</sup> Shih përmbledhjen e përditësuar nga publikimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës <https://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-i-Punes-se-Agjencise-Shteterore-per-te-Drejtat-dhe-Mbrojtjen-e-Femijes-dhe-i-strukturave-te-mbrojtjes-se-femijeve-Viti-2017.pdf>

2. Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara ( i miratuar me VKM nga 2021-2025. <sup>4</sup>

3. Agjenda Kombetare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2021 – 2026.

Plani Lokal Social, specifik për çdo bashki.

**Në rast se ju nevojitet të gjeni se çfarë parashikon ligji për një aspekt të lidhur me situatën e fëmijës suaj, ju mund të:**

1. Pyesni një të afërm, specialist, jurist që zotëron dijeni për këtë fushë.
2. Të klikoni në një nga ligjet e përcaktuara në këtë manual.
3. Ju mund t'i shkruani organeve kompetente për t'ju informuar dhe adresuar saktësisht lidhur me procedurën që duhet të ndiqni.
4. Ju mund të kërkontë informacion nga organizata të shoqërisë civile në komunitetin tuaj të cilat kanë eksperiencë dhe njohuri në këtë fushë.
5. Ju mund të kontaktoni një avokat/jurist të specializuar në këtë fushë.

<sup>4</sup> Shih [https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-\\_2021-2025\\_AL.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-_2021-2025_AL.pdf)

## II. INSTRUMENTET DHE PROCESI I DIAGNOSTIFIKIMIT

### 2.1. Koncepte të përgjithshme të instrumentave dhe procesit të diagnostifikimit.

Procesi i diagnostifikimit i fëmijëve me aftësi të kufizuara është një proces dinamik që përfshin një gamë të gjerë të instrumenteve dhe procedurave për të identifikuar nevojat dhe aftësitë e tyre të kufizuara. Këto janë disa nga instrumentet dhe proceset që janë përdorur gjerësisht në diagnostifikimin e tyre:

**Vlerësimi i zhvillimit:** Kjo përfshin vlerësimin e zhvillimit motorik, kognitiv, social dhe emocional të fëmijës. Instrumente të tilla si lëvizjet e reja të lindjes (motorike), testet e inteligjencës (kognitive) dhe shkala e vlerësimit të sjelljes janë përdorur në këtë proces.

**Testet e shenjave dhe simptomave:** Përdoren për të identifikuar shenjat dhe simptomat e mundshme të problemeve të shëndetit mendor, emocional dhe fizik të fëmijëve. Këto përfshijnë anketa për prindërit dhe mësuesit, si dhe vlerësime klinike.

**Vlerësimi i funksionimit diferencial:** Ky vlerësim i përqendruar në të njëjtën fushë të aftësive si fëmijët e zakonshëm, por në kontekstin e aftësive të kufizuara. Kjo përfshin vlerësimin e aftësive të fëmijëve për të përfshirë dhe përdorur të njëjtin program shkollor dhe për të kryer detyrat e përditshme.

**Vlerësimi i aftësive adaptive:** Ky lloj vlerësimi evidenton aftësitë e fëmijëve për të funksionuar në mënyra të përshtatshme në mjedisin e tyre, përfshin aftësitë kognitive, komunikative, sociale dhe praktike.

**Vlerësimi i nevojave të shërbimeve:** Përdoret për të identifikuar nevojat e fëmijëve për shërbime të ndryshme, si fizioterapi, logopedi, dhe ndihma të tjera shkollore ose sociale.

**Vlerësimi i rrezikut dhe burimet:** Ky vlerësim identifikon rreziqet potenciale dhe burimet e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

**MOS HARRONI!** Ju jeni më pranë fëmijëve tuaj dhe jeni të parët që përmes intuitës prindërore dhe parametrave të shpjeguara më sipër, mund të evidentoni dhe të kuptoni atë që nuk shkon në zhvillimin normal të fëmijës suaj. Bëni kujdes të vlerësoni situatën jo me indiferentizëm të tepruar, por as me doza alarmante. Tregohuni të kujdesshëm dhe objektivë.

### 2.2 Instrumentat dhe hapat sipas OBSH (Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë).

OBSH ka ndërtuar sistemin WHODAS 2.0, i cili është një instrument vlerësimi praktik dhe gjenerik që mund të masë shëndetin dhe aftësinë e kufizuar:

**Fusha 1:** Njohja – të kuptuarit dhe komunikimi.

**Fusha 2:** Lëvizshmëria – lëvizja motorike.

**Fusha 3:** Kujdesi për veten – kujdesi për higjienën e dikujt, veshjen, ngrënien dhe qendrimi vetëm.

**Fusha 4:** Mirëkuptimi – bashkëveprim me njerëz të tjerë në komunitet.

**Fusha 5:** Aktivitetet e jetës – përgjegjësitë shtëpiake, koha e lirë, puna dhe shkolla.

**Fusha 6:** Pjesëmarrja – bashkimi në aktivitete komunitare, pjesëmarrja në shoqëri.

Për të gjashtë fushat, WHODAS 2.0 ofron një profil dhe një masë përmbledhëse të funksionimit dhe aftësisë së kufizuar që është e besueshme dhe e zbatueshme në të gjithë kulturat, në të gjithë botën, duke e rekomanduar aplikimin e skemës edhe në rastet e fëmijëve. Në mënyrë më specifike, ky standard bashkëshoqërohet me instrumentin ICF, i cili paraqet teknikalitete dhe metodologji më specifike sipas rasteve të ndryshme.<sup>5</sup>

***Ju si prindër mund t'i referoheni edhe këtij informacioni të sistemit WHODAS për të kuptuar më shumë rreth këtij instrumenti vlerësues, por në cdo rast mbani parasysh që vlerësimi i fëmijës tuaj qoftë nëpërmjet këtij instrumenti apo metodave të tjera duhet të bëhet nga specialistë të fushës, stafet e specializuara mjekësore, sipas protokolleve mjekësore në fushë dhe në respektim të procedurave përkatëse.***

### 2.3 Identifikimi dhe pranimi.

Kur prindërit mësojnë se fëmija i tyre ka një vonesë në zhvillim, mënyrat e reagimit

janë nga më të ndryshmet, duke përfshirë reagimet/fazat si më poshtë:

<b>Mohimi</b>	<b>Një nga reagimet e para është mohimi</b> - kjo nuk mund të më ndodhë mua, fëmijës tim, familjes sime."
<b>Zemërimi</b>	Mohimi shumë shpejt kalon në <b>zemërim</b> , i cili mund të drejtohet ndaj personelit mjekësor që informon i pari mbi problemin e fëmijës. Zemërimi gjithashtu shfaqet edhe në komunikimin midis vetë prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes.
<b>Refuzimi</b>	<b>Refuzimi</b> është një reagim tjetër që përjetojnë prindërit. Ky refuzim mund t'i drejtohet personelit mjekësor, familjarëve të tjerë apo dhe vetë fëmijës. Ata mund të dëshirojnë edhe vdekjen e fëmijës, kur janë në gjendje të rënduar emocionale.
<b>Frika</b>	<b>Frika është një tjetër reagim i menjëhershëm.</b> Njerëzit zakonisht kanë frikë nga e panjohura më tepër se nga e njohura. Pasja e një diagnoze dhe informacioni të qartë mbi fëmijën, e bën zakonisht situatën më të lehtë. Frika për të ardhmen është një emocion i zakonshëm: "Çdo të ndodhë me fëmijën kur të jetë 5 vjeç, kur të jetë 12, kur të jetë 20? Çdo të ndodhë me fëmijën kur unë të mos jem më?"
<b>Ndjenja e fajit</b>	<b>Më pas vjen ndjenja e fajit</b> dhe shqetësimi se mos kanë qenë prindërit ata që e kanë shkaktuar problemin "Mos bëra diçka që e shkaktoi këtë? Mos po ndëshkohem për diçka që kam bërë? A jam kujdesur si duhet për veten gjatë shtatëzanisë? "

5 [International Classification of Functioning, Disability and Health \(ICF\) \(ëho.int\)](http://www.who.int)

<b>Konfuzioni</b>	<b>Konfuzioni shoqëron këtë periudhë të vështirë.</b> Si rezultat i të moskuptuarit plotësisht se çfarë po ndodh dhe çfarë do të ndodhë, kalohet në pagjumësi, paaftësi për të marrë vendime dhe mbingarkesë mendore.
<b>Pafuqia</b>	<b>Pafuqia për të ndryshuar se çfarë po ndodh</b> është shumë e vështirë për t'u pranuar. Ju nuk mund ta ndryshoni faktin që fëmija juaj ka një vështirësi.
<b>Zhënjimi</b>	<b>Zhënjimi</b> për një fëmijë jo perfekt është një sfidë e madhe për t'u përballuar nga shumë prindër dhe lëndon egon dhe sistemin e vlerave të tyre.
<b>Pranimi</b>	<b>Pranimi</b> është faza kur prindërit krijojnë stabilitet emocional dhe nisin përpjekjet e para për t'i ofruar ndihmë fëmijës duke u drejtuar tek specialistët.

*Jo të gjithë prindërit kalojnë nëpër secilën fazë, por është e rëndësishme për prindërit të njohin këto përjetime të mundshme dhe të kuptojnë që nuk janë të vetëm në vuajtjen e tyre.*

### **Ka shumë mënyra për të përballuar problemet dhe për të kërkuar ndihmë:**

**1. Kërkoni ndihmë nga një prind tjetër:** Kërkoni të njihni një prind tjetër që ka të njëjtin problem si ju dhe kërkoni mbështetjen dhe këshillat e tij.

**2. Flisni me bashkëshortin/bashkëshorten, familjen dhe persona të tjerë të rëndësishëm:** Sa më tepër çifitet të komunikojnë në momente të vështira si këto, aq më tepër forcohen për t'i përballuar. Mënyra se si ju i shikoni dhe përballoni situatat mund të mos jetë e njëjtë. Mundohuni t'i shpjegoni njëri-tjetrit si ndiheni dhe si e shikoni ju situatën në të cilën ndodhëni.

**3. Fokusohuni në të tashmen, në aktivitetet e ditës:** Frika nga e ardhmja mund t'ju dekurajojë. Duhet të mos mendoni në çdo moment për "po sikur?", apo "çdo të ndodhë nesër?". Edhe pse mund t'ju duket e pamundur, gjëra të bukura do të vazhdojnë të ndodhin çdo ditë. Fokusohu në të tashmen, në aktivitetet e ditës.

**4. Kërkoni informacion:** Duhet të kërkoni për informacion të saktë në lidhje me situatën e fëmijës tuaj. Mos kini frikë të pyesni, pasi pyetjet janë hapi i parë për të kuptuar më mirë fëmijën tuaj.

**5. Mësoni si të përballeni me ndjenjën e hidhërimit dhe zemërimit:** Ndjenjat e hidhërimit dhe zemërimit janë të paevitueshme kur mendoni se nuk mund t'ju realizohen shpresat dhe ëndrrat që kishit ndërtuar për fëmijën tuaj. Është e rëndësishme ta njihni dhe ta shprehni zemërimin.

**6. Mbani një qëndrim pozitiv:** Mbajtja e një qëndrimi pozitiv do të jetë një nga armët tuaja kryesore për t'u përballur me problemet.

**7. Qëndroni të lidhur me realitetin:** Të qëndrosh i lidhur me realitetin do të thotë ta pranosh atë ashtu siç është. Gjithashtu do të thotë që ka disa gjëra që mund të ndryshojnë dhe të tjera që nuk i ndryshojmë dot.

**8. Kujdesuni për veten:** Në situata stresante, gjithsecili reagon në mënyrën e tij. Gjithsesi janë të nevojshme disa këshilla: Pushoni mjaftueshëm, ushqehuni mirë, merrni kohë për veten, kërkoni mbështetjen e të tjerëve.

**9. Evitoni keqardhjen:** Keqardhja për veten, keqardhja nga të tjerët apo keqardhja ndaj fëmijës duhen evituar.

**10. Kujtohuni që është fëmija juaj:** Mbi të gjitha ai është fëmija juaj sot e përgjithmonë. Zhvillimi i tij është i ndryshëm nga ai i fëmijëve të tjerë, por kjo nuk e bën fëmijën tuaj më të pavlefshëm, më pak të rëndësishëm, apo me nevojë më të ulët për dashurinë dhe përkujdesjen prindërore. Duajeni dhe gëzojeni fëmijën tuaj.

## III. ÇRREGULLIMET DHE PROCESI I MENAXHIMIT TË AFTËSISË NDRYSHE TË FËMIJËS

### 3.1. Llojet e çrregullimeve.

**Komunikimi** është forma e të shprehurit të mendimeve, ideve, ndjenjave dhe vetvetes në tërësi. Në komunikim përmes sistemit të simboleve të gjuhës dhe artikulimit. Në momentin kur fëmijët shfaqin vështirësi në këto dy aspekte të komunikimit atëherë kemi të bëjmë me:

- **Çrregullime të gjuhës** të cilat karakterizohen nga vështirësi që fëmija i shfaq në të kuptuarin e gjuhës, vështirësi për t'u shprehur përmes gjuhës ose mund të vihet re edhe një kombinim i të dyja vështirësive. Vështirësia lidhet me të kuptuarin dhe përdorimin e sistemit të simboleve të cilat përfshijnë fjalën e folur/fjalën e shkruar/shenjat dhe pikturat.
- **Çrregullimet e të folurit** të cilat karakterizohen nga vështirësi të cilat fëmija i shfaq në prodhimin e tingujve. Në këtë rast fëmija shfaq vështirësi në artikulum, në nxjerrjen e zërit, në rrjedhshmëri ose edhe mund të ketë kombinime të simptomave.

Zakonisht kur fëmija mbush 3 vjeç mund të dallohet nëse ka një përdorim të gjuhës jo të përshtatshëm sipas parametrave të zhvillimit tipik dhe atëherë duhet bërë vlerësimi diagnostik tek specialisti.

Mbani parasysh situatat e mëposhtme të cilat mund të konsiderohen si shenja alarmi:

- në 12 muajsh, nëse fëmija tregon vështirësi në kuptimin e gjuhës.
- në 24 muajsh, nëse fëmija prodhon më pak se 10 fjalë dhe ka vështirësi në kuptimin e gjuhës.
- në 30 muajsh, nëse fëmija prodhon më pak se 50 fjalë dhe nuk fillon të kombinojë bashkë dy fjalë p.sh. "dua topin" dhe ka vështirësi në kuptimin e gjuhës.

Nëse vini re situatë të tilla, kërkohet një ndërhyrje e menjëhershme.

- **Ndërhyrja e hershme** redukton gjatësi që fëmija të përjetojë probleme emocionale dhe edukative në moshën para dhe atë shkollorë; rrit mundësinë e përmirësimit të vështirësive të komunikimit duke e ndihmuar të ndihet i barabartë në aspektin e zhvillimit gjuhësor.
- Mbani në konsideratë se përmes trajtimit terapeutik disa vështirësi të komunikimit mund të përmirësohen, të reduktohen ose edhe të eliminohen në varësi të specifikave.
- Ndërkohë ka edhe vështirësi të cilat mund edhe të mos përmirësohen sikurse do dëshironim pavarësisht trajtimit profesional dhe intensiv.

Çrregullimet kryesore përfshijnë, si më poshtë:

**Çrregullimi i Spektrit të Autizmit** është një çrregullim kompleks që karakterizohet nga dëmtime sociale, vështirësi në komunikim dhe modele sjelljeje të përsëritura dhe stereotipike.

### Shkaqet e Autizmit

Shkaqet e autizmit mbeten ende të panjohura. Shumë studime kanë përfshirë një shumëllojshmëri të gjeneve të zhvillimit, por asnjë prej tyre nuk është gjetur në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë individët e prekur. Faktorët e mjedisit, ekspozimi ndaj viruseve ose toksinave gjatë shtatëzanisë mendohet të kenë ndikim, por asnjë prej tyre nuk është verifikuar plotësisht.

### Identifikimi i hershëm mund të ndryshojë jetë

Studimet tregojnë se diagnostikimi i hershëm dhe ndërhyrja me mbështetjen e duhur çon në rezultate shumë më të mira nga trajtimi.

### Mos prit! Identifikimi i hershëm mund të ndryshojë jetën e fëmijës tuaj

Shiko dhe vlerëso ecurinë e fëmijës tënd gjatë 3 viteve të para të jetës:

#### Kur fëmija arrin moshën 12 muaj:

#### VEPRIME TË ZHVILLIMIT NORMAL

- Shikon me vëmendje fytyrat dhe i përgjigjet shprehjes së emocioneve të njerëzve të tjerë.
- Buzëqesh dhe imiton disa shprehje të fytyrës, ndjek me sy levizjen e objekteve.
- Fillon të belbëzojë, imiton tingujt dhe fjalët, fut dorën në gojë.
- Përdor fjalë teke si “baba”, përsërit tinguj apo gjeste për të fituar vëmendje.
- Kthen kokën nga drejtimi i tingujve, përgjigjet për emrin e tij.
- Qesh me nënën apo persona të tjerë të afërt dhe preferon ata mbi gjithë të tjerët.
- Mund të ulet pa ndihmë, mund të qendrojë në këmbë, mund të ecë duke u mbajtur tek mobiljet.
- Lëviz dorën për të thënë “mirupafshim” dhe drejton gishtin për të treguar objekte.

#### VEPRIME TË ZHVILLIMIT JO NORMAL

- Nuk ndjek fytyrat dhe nuk orientohet me personat afër tij.
- Nuk i kushton vëmendje ose frikësohet nga fytyrat e reja.
- Nuk buzëqesh dhe nuk ndjek me sy lëvizjen e objekteve.
- Nuk belbëzon, nuk qesh dhe ka vështirësi të fusë në gojë objektet.



**Kur fëmija arrin 12 deri në 24 muaj:****VEPRIME TË ZHVILLIMIT NORMAL**

- Ecën vetëm, me mbështetje mund të ngjise shkallët, mban dhe tërheq lodra duke ecur.
- Përdor disa fjalë të vetme nga 15 në 18 muaj, përdor fraza të thjeshta në 24 muaj.
- Imiton sjelljen e të tjerëve, kënaqet në shoqërinë e fëmijëve të tjerë.

**VEPRIME TË ZHVILLIMIT JONORMAL**

- Nuk merr dhe shfaq emocionet nga realiteti përreth.
- Nuk mund të ecë deri në 18 muaj, nuk mund të shtyjë një lodër me rrota.
- Nuk e njeh funksionin e objekteve të zakonshme shtëpiake deri në 15 muaj.

**Kur fëmija arrin 24 deri 36 muaj:****VEPRIME TË ZHVILLIMIT NORMAL**

- Përdor fjali me 4-5 fjalë, kupton shumë fjali dhe udhëzime.
- Imiton të rriturit dhe shokët e lojës, shpreh afekcion në mënyrë të hapur, ndahet lehtësisht nga prindërit.
- Grupon objektet sipas formës dhe ngjyrës.
- Ngjitet, vrapon, gjuan topin, ngjit shkallët pa ndihmë.
- Fiton shkathtësinë për t'u lidhur me realitetin përreth.

**VEPRIME TË ZHVILLIMIT JONORMAL**

- Nuk flet.
- Nuk kthen kokën nga vijnë tingujt dhe mund të mos reagojë ndaj zhurmave të forta.
- Nuk tregon afekcion ndaj personit që kujdeset për të, nuk pëlqen përqafimet.
- Nuk zvarritet, nuk mund të qëndrojë mbështetur.
- Nuk përdor gjeste të tilla si përshëndetja me dorë apo drejtimi i gishtit për të treguar objekte.
- Nuk flet, nuk imiton veprimet e të tjerëve, nuk mund të ndjekë udhëzime të thjeshta.
- Ka një të folur shumë të kufizuar, nuk përdor fraza të shkurtra, ka vështirësi në të kuptuarin e udhëzimeve të thjeshta.
- Ka pak interes për fëmijët e tjerë, ka vështirësi të ndahet nga nëna.
- Ka vështirësi për të përdorur objekte të vogla.
- Rrëzohet shpesh, ka vështirësi në ngjitjen e shkallëve

**Dëmtimi i dëgjimit:** një problem në një ose më shumë pjesë të veshit që e pengon fëmijën të dëgjojë në mënyrë adekuatë. Një nga më të zakonshmet *paaftësi të lindura* (i pranishëm që nga lindja, por mund të mos jetë i trashëguar). Një fëmijë me dëmtim të dëgjimit shpesh mund të identifikohet nga mungesa e fjalorit dhe vonesat e përgjithshme në zhvillimin e gjuhës. Humbja e dëgjimit mund të variojë nga e lehtë në të thellë. Aparati i dëgjimit përforcon dhe zmadhon tingujt.

*Kur i afroheni një fëmije me dëmtim të dëgjimit:*

- zbritni në nivelin e syve të fëmijës, mbaj kontaktin me sy,
- tërhiqni vëmendjen e fëmijës përpara se të flisni,
- flisni me volum dhe shpejtësi normale,
- flisni qartë,
- përdorni të njëjtën strukturë fjalie si për fëmijët e tjerë,
- pushoni dhe prisni një përgjigje pasi të flisni, nëse fëmija nuk ju kupton, përsërisni,
- riformuloni ose demonstroni,
- inkurajoni fëmijët e tjerë që t'ju imitojnë kur komunikojnë me fëmijën,
- përdorni gjeste dhe shprehje të fytyrës për të përforcuar fjalën e folur,
- lëreni fëmijën të ulet në grup me fëmijët e tjerë.

**Problemet e artikulacionit:** janë më së shpeshti lëshime, shtrembërime ose zëvendësime të zanoreve ose bashkëtingëlloreve ose të dyja. Zëvendësimi është kur përdoret një tingull i pasaktë. Pasi një fëmijë të jetë diagnostikuar se ka një problem artikulimi, duhet të konsultohet me një klinikist të të folurit. Karakteristikat e zërit përfshijnë lartësinë, zhurmën, fleksibilitetin dhe cilësinë. Një zë i mirë i të folurit gjatë bisedës rutinë përdor një shumëllojshmëri të lartësive dhe niveleve të zërit. Ashpërsia, ngjirja e zërit, marrja e frymës dhe e folura e çrregullt me hundët janë të gjitha çrregullime të cilësisë së zërit. Belbëzimi tek fëmijët e vegjël karakterizohet nga përsëritje, hezitim dhe zgjatje. Shumë fëmijë përjetojnë belbëzimin në fazat e hershme të zhvillimit të gjuhës. Më shpesh ndodh kur ndihen nën presion.

*Nëse keni fëmijë që belbëzojnë:*

- përqendrohuni në krijimin e kushteve të mira të të folurit,
- planifikoni aktivitete në mënyrë që fëmijët të kenë sukses,
- jepini fëmijëve kohë të mjaftueshme për të thënë atë që kanë për të thënë,
- dëgjoni me vëmendje,
- mos u fokusoni në belbëzimin,
- shmangni nxitimin e fëmijëve në një detyrë.

### 3.2 Llojet e shërbimeve.

Shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara janë të rëndësishme për të siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie si dhe për të ndihmuar ata të zhvillojnë potencialet e tyre të plotë.

Disa nga llojet e shërbimeve që mund të ofrohen për këtë grup të fëmijëve përfshijnë:

- 1. Arsimimi i përgjithshëm dhe i personalizuar:** Programet arsimore duhet të jenë të përshtatura për nevojat e individëve me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin mësimin e shumë llojeve të aftësive, duke përdorur metoda të ndryshme mësimore dhe materiale të përshtatura.
- 2. Terapia dhe rehabilitimi:** Shërbime terapeutike si fizioterapia, terapia okupacionale, terapia gjuhësore janë të rëndësishme për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara të zhvillojnë aftësitë motorike, gjuhësore dhe të tjera.
- 3. Ndihma dhe mbështetja shoqërore:** Programet që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje shoqërore mund të përfshijnë trajnime për prindërit, asistencë për të integruar fëmijët në shoqëri dhe ndihmë për të menaxhuar sfidat e përditshme.
- 4. Aftësimi dhe përgatitja për punë:** Përfshirja në programe që ofrojnë aftësim dhe përgatitje për punë për fëmijët me aftësi të kufizuara është e rëndësishme për të siguruar që ata të kenë mundësi për një karrierë të suksesshme dhe për të qenë të pavarur në të ardhmen.
- 5. Mbështetje mjekësore:** Sigurimi i aksesit në kujdes mjekësor dhe mbështetje mjekësore të specializuar për nevojat e tyre të veçanta është jetik për të siguruar mirëqenie dhe shëndet të mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 6. Programet shtëpiake dhe komunitare:** Programet shtëpiake dhe komunitare ofrojnë një mënyrë për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara në mjedisin e tyre të njohur, duke integruar ndihmën dhe mbështetjen nga familja dhe komuniteti.

## IV. STRUKTURAT MBËSHTETËSE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Strukturat bashkëpunuese që funksionojnë dhe kanë lidhje me ofrimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin tonë i përkasin një skeme dinamike.

Ju mund t'i drejtoheni një prej strukturave të mëposhtme sipas rolit dhe funksionit që kryejnë.

**Pushteti legjislativ: Kuvendi:** Ju mund të konsultoni vazhdimisht pranë zyrave të Kuvendit apo edhe në faqen zyrtare informacione të ligjeve, ndryshimeve, projektligjeve apo aktiviteteve që lidhen me trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në mënyrë specifike, trajtimi i kësaj kategorie është fokus i veçantë i **Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë**.

**Pushteti ekzekutiv:** Pushteti ekzekutiv luan një rol të dyfishtë për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke 'patur në duar':

- a. propozimin e ligjeve të reja apo ndryshimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke gëzuar iniciativën legjislative sipas Kushtetutës.
- b. implementon, vendos në zbatim dimensionet e kërkuara ligjore (psh një VKM është një akt ligjor i cili nxirret në bazë të ligjit dhe implementon në detaje kërkesat ligjore).

**Këshilli i Ministrave** është struktura gjithpërfshirëse që bën të mundur zbatimin dhe krijimin e politikave për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në faqen e Kryeministrit ne mund të gjejmë informacionin gjithpërfshirës të ministrave aktuale dhe kontakteve relevante. Kështu, secila **Ministri** mund të ketë lidhje direkte apo indirekte sipas funksionit të tyre për një aspekt referuar fëmijëve me aftësi të kufizuara (psh. Ministria e Transportit për të krijuar disa facilitete infrastrukturore për fëmijët me aftësi të kufizuara).

Në mënyrë specifike, Ministria që ka kompetencë ekskluzive është **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**. Ministria është organi që menaxhon funksionimin e strukturave të shërbimeve shoqërore, edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ministria realizon aktiviteteve të herë-pas-hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara, takime me aktorët relevantë që punojnë në këtë fushë, si dhe japin informacion të përditësuar ligjor. Sipas strukturës aktuale, **Spektori për Zhvillimin e Politikave për Personat me Aftësi të Kufizuara** përgjigjet specifikisht lidhur me ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Jo më pak të rëndësishme, duke u ndodhur edhe më pranë komuniteteve përkatëse janë edhe institucionet e varësisë të cilat menaxhojnë politika të mëvetëshme dhe të detajuara për këtë dimension. Mund të përmendim:

**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve:** struktura e këtij institucioni ka vendosur në agjendën e aktiviteteve edhe mbrojtjen apo përmirësimin e shërbimeve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**Shërbimi Social Shtetëror:** Shërbimi Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin.

**Pushteti gjyqësor: Gjykatat** në vendin tonë (Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative) mund të jenë strukturat që mund të konsiderohen për të kërkuar një të drejtë të mohuar, të shkelur, apo të pamenaxhuar si duhet nga ana e institucioneve të administratës publike referuar fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edhe pse rekomandohet të shihet apo trajtohet si shkalla e fundit për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, sjellim në vëmendje kryesore se:

Në çdo rast gjykimi, rastet për fëmijët me aftësi të kufizuara shqyrtohen gjithnjë në praninë e punonjësve psikologë dhe staf mbështetës, duke siguruar për sa të jetë e mundur dhoma apo ambiente të mëvetësishme nga ambientet ku shqyrtohen çështjet për të rritur.

Gjykatat mund të cilësohen si një mundësi e mirë për të 'dënuar' sjelljet e paduhura apo standardin e ulët të stafeve të shërbimeve shoqërore lidhur me këtë aspekt, duke theksuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijës.

**Pushteti vendor:** Ligji nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore' u vesh strukturave të pushtetit vendor detyrën e krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në këtë mënyrë, **bashkitë** apo **njësitë administrative** janë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në fushën e menaxhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara bashkia, njësia administrative përkatëse dhe drejtoria përkatëse rajonale e shërbimit social kanë njëkohësisht detyrën e menaxhimit, përmirësimit dhe rritjes së standardeve të këtyre shërbimeve.

Psh. Qendrat Ditore janë struktura të përcaktuara me VKM dhe që financohen nga buxheti i shtetit (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe nga bashkia.

Bashkia konsiderohet të luajë një rol decisiv sidomos në identifikimin e rasteve dhe përcjelljen e tyre në struktura të tjera me qëllim marrjen e ndihmës në mënyrë sa më eficiente dhe duke minimizuar aspektet e burokratizimit.

**Institucione të pavarura: Avokati i Popullit,** Komisioneri për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Komisioni për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit mbeten gjithashtu struktura me një rol të konsiderueshëm për analizën dhe identifikimin e situatës në vend për fëmijët me AK si dhe me respektimin e standardeve. Këto dy institucione në raportime periodike apo vjetore trajtojnë në një rubrikë të posaçme përmirësimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin tonë.

**Media:** Raste të ndryshme me efekt ndërgjegjësimi për rastet individuale apo edhe në përgjithësi të trajtimit të fenomenit në Shqipëri përmes mediave, shërbejnë për të nxitur reagimin e opinionit publik, por edhe të strukturave vendimmarrëse lidhur me këtë aspekt. Rekomandohet që publikimi i rasteve në media të respektojë maksimalisht dinjitetin dhe të dhënat personale, duke mos patur në fokus abuzimin, por përmirësimin e situatave.

**Organizata ndërkombëtare apo të shoqërisë civile: Organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare,** të cilat janë të shumta dhe operojnë prej disa vitesh në vendin tonë, kanë realizuar dhe po zbatojnë projekte që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara. Misioni dhe vizioni i tyre bëhet punë mbështetëse për strukturat e shërbimeve shoqërore. Rekomandohet mbajtja dhe ndërtimi i kontakteve

të vazhdueshme me këto organizata me qëllim fuqizimin dinamik të punës që duhet realizuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.

**Biznese:** Edhe pse në mënyrë indirekte, bizneset përmes fondeve të kujdesit social mund të bëhen mbështetës në komunitete të ndryshme lidhur me mbështetje infrastrukturore apo edhe sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mbajtja në fokus e këtyre strukturave do t'i shërbente menaxhimit sa më të suksesshëm të këtij dimension.

### Strukturat në nivel lokal

**Drejtoria e Shërbimeve Sociale** në nivel bashkiak është një strukturë lokale, pjesë e Bashkisë Kavajë e cila drejton politikat sociale në nivel lokal dhe organizon ofrimin e shërbimeve sociale ndaj grupeve në nevojë, duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara. Drejtoria përbëhet nga dy sektorë: Sektori i pagesave të ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara si dhe sektori i shërbimeve sociale.

Detyrat kryesore të Drejtorive të Shërbimeve Sociale janë ofrimi i shërbimeve për fëmijët dhe familjet e tyre. Gjithashtu, këto departamente ose sektorë janë përgjegjës për identifikimin e fëmijëve në nevojë në zonën e tyre dhe ofrimin e informacionit për shërbime; për mbajtjen e një regjistri për fëmijët me aftësi të kufizuara; për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara që minimizojnë efektin e aftësive të tyre të kufizuara dhe dhënien e mundësisë që ata të bëjnë një jetë sa më normale që të jetë e mundur; për ofrimin për fëmijët që jetojnë me familjet e tyre elementet e mëposhtme:

- Këshilla, udhëzime dhe këshillim; aktivitete profesionale, sociale, kulturore ose argëtuese; ndihmë në shtëpi (që mund të përfshijë pajisje larëse);
- lehtësira ose ndihmë për udhëtime nga shtëpia dhe për në shtëpi, për të përfituar nga shërbimet;
- asistencë për t'i mundësuar fëmijës dhe familjes së tij/saj të bëjnë një pushim.

Plani i veprimit parashikon që drejtorja e shërbimit social në bashki të përmirësojë vlerësimin e aftësisë së kufizuar duke kaluar nga modeli mjekësor në modelin biopsikosocial; ai parashikon gjithashtu ofrimin e shërbimeve sociale duke kombinuar ndihmën financiare në të holla me kujdesin social cilësor. Gjithashtu, për vazhdimin e sigurimit të përfitimeve në të holla është e nevojshme të ofrohet një larmi e madhe e shërbimeve komunitare për të promovuar deinstitutionalizimin.

**Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NjMF)** – një strukturë e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Kavajë e cila ka për qëllim për të mbikëqyrur, koordinuar dhe vënë në zbatim ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës brenda bashkisë. Ato koordinojnë ekipet ndërdisiplinore për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të tilla si: raste të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit të fëmijës, dhunës në familje, etj.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

- a) të mbështesë punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

- b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, të ndjekë zbatimin e masave të mbrojtjes si dhe të hartojë dhe ndjekë planet individuale të mbrojtjes duke mbikëqyrur mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;
- c) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse;
- d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;
- e) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;
- f) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/ komunës;
- g) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.

**Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NjVNR)** të rasteve është një komponent shumë i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në nivel vendor. Qëllimi i saj është të identifikojë individët dhe familjet në nevojë, të vlerësojë nevojat dhe nivelin e riskut për këta individë, dhe të ofrojë informacion dhe këshillim mbi shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore. Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit ka një rol kyç në garantimin e barazisë dhe të drejtave të barabarta për grupet në nevojë dhe vulnerabël, duke përfshirë viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuara, familjet me probleme sociale, familjet në varfëri, grupet e marginalizuara dhe të moshuarit me vështësi ekonomike ose shëndetësore. Projekti i ngritjes së kësaj njësie është një hap drejt krijimit të një infrastrukture të përshtatshme për sektorin social, duke përmirësuar shërbimet për komunitetin në nevojë. Për të realizuar funksionet e përcaktuara, njësia duhet të ketë një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë.

- Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NjVNR) – një strukturë lokale e cila duhet të ngrihet në çdo njësi administrative ka për qëllim:
- Vlerësimin e nevojave të komunitetit për shërbime sociale të orientuara drejt nevojave reale të komunitetit;
- Identifikimin e nevojave dhe mënyrave se si shpërndahen shërbimet ekzistuese;
- Vlerësimin sistematik të programeve ekzistuese dhe planifikimet për përmirësimin e shërbimeve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve rreth problemeve të komunitetit dhe efektet që këto probleme mund të kenë mbi komunitetin e tyre;
- Rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet rreth planifikimit të përbashkët komunitar.

### Qendra Ditore «Ngjyrat e Jetës»

Kjo qendër ditore administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkinë Kavajë. Numri total i përfituesve në qendrën ditore në momentin e hartimit të këtij manuali rezulton të jetë në total 17 fëmijë.

Kapacitetet e shërbimeve për qendrën ditore mbulojnë 25 – 30 persona me aftësi të kufizuar dhe numri i përdoruesve në kohën e hartimit të këtij manuali ishte më i vogël, 17 persona.

Në këtë qendër ofrohet mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë asistencë në edukim dhe rehabilitim, ndërhyrje për të arritur autonominë individuale në veprimet e përditshme, si dhe mbështetje për ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive drejt integritimit social. Po ashtu realizohen aktivitete kreative dhe kulturore, si dhe ofrohen vakte ushqimore për përfituesit.

Qendra është e hapur cdo ditë të javës, nga e hënë në të premte, ora 08:00 - 16:00.

Vendodhja e qendrës është: Rruga e Metalikës, pranë shkollës profesionale “26 Marsi”, 2501, Kavajë.

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni në:

Nr. Tel: +355 68 880 6971

Email: QendraDitoreKavaje@outlook.com

### “ABA Therapy Centre” në Kavajë

ABA Therapy Centre në Kavajë është një qendër private që ofron terapi të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim mbështetjen e tyre për të realizuar aktivitetet e përditshme dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre drejt integritimit social. Terapia ABA (Analiza e Sjelljes së Aplikuar) është një metodë shkencore që përdoret për të përmirësuar ose ndryshuar sjellje specifike, veçanërisht te individët me çrregullim të spektrit të autizmit (ASD). ABA fokusohet në analizimin e sjelljes, ndikimin e mjedisit në sjellje dhe mënyrën se si ndodh mësimi.

#### Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- **Programe të personalizuar:** Çdo plan terapi përshtatet sipas nevojave specifike të individit.
- **Përforsimi pozitiv:** Kur individi shfaq një sjellje të dëshiruar, ai shpërblehet, duke e inkurajuar që ta përsërisë sjelljen.
- **Mbledhja e të dhënave:** Terapistët mbledhin të dhëna për të monitoruar progresin dhe për të bërë rregullime në planin e terapisë.
- **Aftësi të synuara:** ABA fokusohet në mësimin e aftësive të komunikimit, sociale dhe jetës së përditshme, duke reduktuar sjelljet problematike.

ABA Therapy Centre është e hapur cdo ditë të javës, e hënë - e premte, ora 09:00 - 16:00.

Vendodhja e qendrës është: Rruga Hasan Gjeci 3562, Kavajë, Shqipëri.

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni në:

Nr. Tel: +355 67 228 8888

Email: lorela.bodari@yahoo.com



Ky projekt mbështetet nga:

**#ReLOaD**

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit «Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2», i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACFD) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).